



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:064290
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05597238

C.nr.580/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit I.B. nga P., të cilin e përfaqëson Faruk Binakaj avokat nga Peja, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, Rr. Sheshi “Nëna Terezë”, me bazë juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjesisë, vlera e kontestit 1000 euro, jashtë seance me datën 19.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit I.B. nga P., e parashtruar me datë 08.06.2020, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjesisë, vlera e kontestit 1000 euro.

II. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi I.B. nga P., ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria”- Prishtinë me bazë juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjesisë, vlera e kontestit 1000 euro.

Gjykata, me datën 29.02.2024, ka pranuar parashtrësën e paditësit, me anë të së cilës parashtrësë, i njëjti ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës me arsyetim se të njëjtit kanë arritur ujdi jashtëgjyqësore me këtu të paditurën Kompania e Sigurimeve “Illyria”- Prishtinë.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se

plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.580/20, me datë 19.04.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.